




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të LVL-së, e në zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/ datë 03 Prill 2019), Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur me datë 26.02.2026, miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për dhënien e tyre në shfrytëzim për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë gjatë vitit 2026.

- 1.Kuvendi i Komunës Aprovon Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për dhënien e tyre në shfrytëzim për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë gjatë vitit vijues 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e pronave e cila përbëhet nga pjesa tekstuale e të dhënave kadastrale si dhe destinimi i tyre si dhe nga pjesa grafike - ortofoto ku shihet forma gjeometrike e këtyre pronave dhe vendndodhja.
3. Vetëm pronat e paluajtshme të cilat janë pjesë e kësaj liste mund të jenë objekt i kërkesave të personave fizik dhe juridik për marrjen e tyre në shfrytëzim dhe objekt i shqyrtimit në procedurat e dhënies së tyre në shfrytëzim.
4. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi obligohet personi përgjegjës nga administrata e komunës ta publikon listen në Faqen Zyrtare Elektronike në mënyrë që t'i mundësohet qasja e barabart të gjitha palëve të interesuara për marrjen e tyre në shfrytëzim.
- 5.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesja e Kuvendit Komunal Gjiçan.

01.Nr.016-15752/26

Gjiçan, më 26.02.2026



Kryesuesja e Kuvendit

[Signature]
/Krenare Latifi Kqiku/